

LIGJ
Nr. 19/2022

**PËR ADERIMIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË KONVENTËN
NDËRKOMBËTARE PËR KONTROLLIN E DËMIT NGA SISTEMET
PËR MBROJTJEN ANTIVEGJETATIVE NË ANIJE (*ANTI-FOULING*), 2001**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Republika e Shqipërisë aderon në Konventën Ndërkombëtare për Kontrollin e Dëmit nga Sistemet për Mbrojtjen Antivegjetative në Anije (*anti-fouling*), 2001, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 24.2.2022.

Shpallur me dekretin nr. 13510, datë 16.3.2022, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta.

ORGANIZATA NDËRKOMBËTARE DETARE



IMO

E

KONFERENCË NDËRKOMBËTARE PËR
KONTROLLIN E DËMIT NGA SISTEMET PËR
MBROJTJEN ANTIVEGJETATIVE PËR ANIJET
(ANTI-FOULING)
Pika 8 e Agjendës

AFS/CONF/26
18 tetor 2001
Originali: Anglisht

**MIRATIMI I AKTIT PËRFUNDIMTAR TË KONFERENCËS DHE I TË GJITHA
INSTRUMENTEVE, REKOMANDIMEVE DHE REZOLUTAVE, QË VIJNË NGA
PUNIMET E KONFERENCËS**

**KONVENTË NDËRKOMBËTARE PËR KONTROLLIN E DËMIT NGA
SISTEMET PËR MBROJTJEN ANTIVEGJETATIVE NË ANIJE
(*ANTI-FOULING*) 2001
Teksti i miratuar nga Konferenca**

1. Si rezultat i shqyrtimeve të saj, siç është regjistruar në Regjistrin e Vendimeve të Konferencës (AFS/CONF/RD/2) dhe në Aktin Përfundimtar të Konferencës

(AFS/CONF/25), Konferenca miratoi Konventën Ndërkombëtare për Kontrollin e Dëmit nga Sistemet Për Mbrojtjen Antivegetative në Anije (*anti-fouling*) 2001.

2. Konventa e përmendur më sipër, e miratuar nga Konferenca, gjendet e bashkëlidhur në këtë dokument.

Për arsye ekonomike, ky dokument është shtypur në një numër të kufizuar. Delegatëve u kërkohet të sjellin kopjet e tyre në mbledhje dhe të mos kërkojnë kopje shtesë.

AFS/CONF/26

SHTOJCË
KONVENTË NDËRKOMBËTARE PËR KONTROLLIN E DËMIT NGA SISTEMET
PËR MBROJTJEN ANTIVEGETATIVE NË ANIJE (*ANTI-FOULING*) 2001

Palët në këtë Konventë,

duke theksuar se studimet shkencore dhe hetimet nga qeveritë dhe organizatat ndërkombëtare kompetente kanë treguar që disa sisteme për mbrojtjen antivegetative të përdorura për anijet paraqesin rrezik të konsiderueshëm të lëndëve toksike dhe ndikime të tjera kronike për organizmat detarë të rëndësishëm në aspektin ekologjik dhe ekonomik dhe, gjithashtu, që shëndeti i njeriut mund të dëmtohet si rezultat i konsumit të ushqimeve të detit të prekura;

duke theksuar në veçanti shqetësimin serioz, në lidhje me sistemet e mbrojtjes antivegetative për anijet që përdorin komponimet organike, si biocidet dhe duke qenë të bindur se përfshirja e këtyre përbërjeve organike në mjedis duhet të ndërpritet;

duke rikujtuar se kapitulli 17 i Agjendës 21, të miratuar nga Konferenca e Kombeve të Bashkuara për Mjedisin dhe Zhvillimin, 1992, u bën thirrje shteteve të marrin masa për të reduktuar ndotjen e shkaktuar nga komponimet organike të përdorura në sistemet e mbrojtjes antivegetative për anijet;

duke kujtuar, gjithashtu, se rezoluta A.895 (21), e miratuar nga Asambleja e Organizatës Ndërkombëtare Detare më 25 nëntor 1999, kërkon që Komiteti i Mbrojtjes së Mjedisit Detar i Organizatës (MEPC) të punojë drejt zhvillimit të shpejtë të një instrumenti global detyrues juridik për të trajtuar pasojat e dëmshme të sistemeve të mbrojtjes antivegetative për anijet si çështje urgjente;

duke qenë në dijeni të qasjes paraprake të parashtruar në parimin 15 të Deklaratës së Rios për Mjedisin dhe Zhvillimin dhe referuar në rezolutën MEPC.67(37), të miratuar nga MEPC-ja, më 15 shtator 1995;

duke pasur parasysh rëndësinë e mbrojtjes së mjedisit detar dhe të shëndetit të njeriut nga efektet negative të sistemeve të mbrojtjes antivegetative për anijet;

duke pasur parasysh, gjithashtu, se përdorimi i sistemeve të mbrojtjes antivegetative për anijet në parandalimin e krijimit të organizmave në sipërfaqen e anijeve ka një rëndësi kritike për efikasitetin e tregtisë, transportit dhe pengimin e përhapjes së organizmave të dëmshëm ujorë dhe patogjenëve,

duke pasur parasysh më tej nevojën për të vijuar zhvillimin e sistemeve të mbrojtjes antivegetative për anijet, të cilat janë efikase dhe të sigurta për mjedisin dhe për të nxitur zëvendësimin e sistemeve të dëmshme nga sisteme më pak të dëmshme ose sisteme mundësisht të padëmshme,

palët bien dakord sa më poshtë.

Neni 1
Detyrime të përgjithshme

1. Secila Palë e kësaj Konvente merr përsipër të zbatojë plotësisht dhe në tërësi dispozitat e

saj, në mënyrë që të reduktojë ose të eliminojë efektet negative në mjedisin detar dhe shëndetin e njeriut të shkaktuara nga sistemet e mbrojtjes antivegetative për anijet.

2. Shtojcat janë pjesë përbërëse kësaj Konvente. Përveç nëse parashikohet shprehimisht ndryshe, një referencë për këtë Konventë përbën në të njëjtën kohë një referencë për shtojcat e saj.

3. Asnjë dispozitë e kësaj Konvente nuk interpretohet si pengesë që një Shtet të marrë, individualisht ose bashkërisht, masa më të rrepta, në lidhje me reduktimin ose eliminimin e efekteve negative të sistemeve të mbrojtjes antivegetative për anijet mbi mjedisin, në përputhje me të drejtën ndërkombëtare.

4. Palët do të përpiqen të bashkëpunojnë për qëllimin e zbatimit, përputhshmërisë dhe përforcimit efektiv të kësaj Konvente.

5. Palët marrin përsipër të inkurajojnë zhvillimin e vazhdueshëm të sistemeve të mbrojtjes antivegetative për anijet, të cilat janë efikase dhe të sigurta për mjedisin.

Neni 2 Përkufizime

Për qëllime të kësaj Konvente, përveç nëse parashikohet shprehimisht ndryshe:

1. “Administratë” është Qeveria e Shtetit nën autoritetin e së cilës po operon anija. Në lidhje me një anije që gëzon të drejtën të mbajë flamurin e një Shteti, Administrata është Qeveria përfaqësuese e këtij Shteti. Në lidhje me platformat fikse ose lundruese të angazhuara në kërkimin dhe shfrytëzimin e shtratit të detit dhe nëntokës së tij ngjitur me bregdetin mbi të cilin Shteti bregdetar ushtron të drejtat sovrane, për qëllime të kërkimit dhe shfrytëzimit të burimeve të tyre natyrore, Administrata është Qeveria e Shtetit bregdetar në fjalë.

2. “Sistem i mbrojtjes antivegetative për anijet” është një shtresë, lysterje, trajtim i sipërfaqes ose pajisje që përdoret nëpër anije për të kontrolluar apo për të parandaluar mbartjen e organizmave të padëshiruar.

3. “Komitet” është Komiteti i Mbrojtjes së Mjedisit Detar i Organizatës.

4. “Tonazh bruto” është tonazhi bruto i llogaritur në përputhje me rregulloret e matjes së tonazhit të përfshira në shtojcën 1, të Konventës Ndërkombëtare të vitit 1969, për Matjen e Tonazheve të Anijeve ose në ndonjë Konventë pasuese.

5. “Udhëtim ndërkombëtar” është një udhëtim nga një anije që ka të drejtë të ngrrejë flamurin e një Shteti drejt ose nga një port, kantier detar ose terminal në det nën juridiksionin e një Shteti tjetër.

6. “Gjatësi” është gjatësia, siç përcaktohet në Konventën Ndërkombëtare për Linjat e Ngarkesave, 1966, e modifikuar nga Protokollin e vitit 1988, që lidhet me të, ose ndonjë Konventë e mëvonshme.

7. “Organizatë” është Organizata Ndërkombëtare Detare.

8. “Sekretar i Përgjithshëm” është Sekretari i Përgjithshëm i Organizatës.

9. “Anije” është një anije e çfarëdo lloji, që operon në mjedisin detar dhe përfshin varka hidrofile, mjete me jastëk ajri, nëndetëse, anije lundruese, platforma fikse ose lundruese, njësi ruajtëse lundruese (FSU-të) dhe njësi ruajtëse prodhimi dhe shkarkimi (FPSO-të).

10. “Grupi teknik” është një organ i përbërë nga përfaqësues të Palëve, Anëtarëve të Organizatës, Kombeve të Bashkuara dhe Agjencive të Specializuara të saj, organizatave ndërqeveritare, që kanë marrëveshje me Organizatën, dhe organizatave joqeveritare në status konsultativ me Organizatën, në të cilin duhet të përfshihen mundësisht përfaqësues të institucioneve dhe laboratorëve, që merren me analizën e sistemit të mbrojtjes antivegetative për anijet – këta përfaqësues zotërojnë ekspertizën e duhur lidhur me fatin dhe efektet mjedisore, efektet toksikologjike, biologjinë detare, shëndetin e njeriut, analizën ekonomike, menaxhimin e rreziqeve, transportin ndërkombëtar, teknologjinë e veshjes së sistemeve të mbrojtjes antivegetative për anijet ose në fusha të tjera të ekspertizës të nevojshme për të rishikuar në

mënyrë objektive anët teknike të propozimit gjithëpërfshirës.

Neni 3 Zbatimi

1. Nëse nuk përcaktohet ndryshe në këtë Konventë, kjo Konventë zbatohet, për:
 - a) anije që kanë të drejtë të ngrenë flamurin e një Pale;
 - b) anije që nuk kanë të drejtë të ngrenë flamurin e një Pale, por që operojnë nën autoritetin e një Pale; dhe
 - c) anije që hyjnë në një portin, kantierin detar ose terminalin në det të një Pale, por nuk bëjnë pjesë në nënparagrafin (a) ose (b).
2. Kjo Konventë nuk zbatohet për asnjë anije luftarake, mjete ndihmëse detare ose anije të tjera në pronësi ose të operuara nga një Palë dhe të përdorura, për momentin, vetëm për shërbime qeveritare jotregtare. Megjithatë, secila Palë siguron, me miratimin e masave të duhura që nuk dëmtojnë operacionet ose aftësitë operacionale të këtyre anijeve në pronësi ose të operuara prej saj, që këto anije do të veprojnë në përputhje, për aq sa është praktikisht e arsyeshme, me këtë Konventë.
3. Në lidhje me anijet e shteteve jopalë të kësaj Konvente, Palët zbatojnë kërkesat e kësaj Konvente që mund të jenë të nevojshme për të garantuar trajtimin jofavorizues ndaj këtyre anijeve.

Neni 4 Kontrolle në Sistemet e Mbrojtjes Antivegjetative për Anijet

1. Në përputhje me kërkesat e specifikuar në shtojcën 1, çdo palë ndalon dhe/ose kufizon:
 - a) zbatimin, rizbatimin, instalimin ose përdorimin e sistemeve të dëmshme të mbrojtjes antivegjetative për anijet, në anijet e përmendura në nenin 3(1)(a) ose (b); dhe
 - b) zbatimin, rizbatimin, instalimin ose përdorimin e këtyre sistemeve, gjatë kohës në portin, kantierin detar ose terminalin në det të një Pale, në anijet e përmendura në nenin 3(1)(c), dhe merr masa efektive për të siguruar që këto anije i përmbushin ato kërkesa.
2. Anijet që kanë një sistem të mbrojtjes antivegjetative, i cili kontrollohet përmes një ndryshimi në shtojcën 1 pas hyrjes në fuqi të kësaj Konvente, mund ta mbajnë atë sistem deri në rinovimin tjetër të planifikuar të këtij sistemi, por në asnjë rast për një periudhë që tejkalon 60 muaj pas aplikimit, përveç nëse Komiteti vendos që ekzistojnë rrethana të jashtëzakonshme për të garantuar zbatimin e hershëm të kontrollit.

Neni 5 Kontrollet e shtojcës 1, mbetjet

Duke marrë parasysh rregullat, standardet dhe kërkesat ndërkombëtare, një Palë merr masat e duhura në territorin e saj për të kërkuar që mbetjet nga aplikimi ose heqja e një sistemi të mbrojtjes antivegjetative për anijet, të kontrolluar në shtojcën 1 të mblidhen, trajtohen, menaxhohen dhe depozitohen në një vend të sigurt dhe mënyrë të shëndetshme për të mbrojtur shëndetin e njeriut dhe mjedisin.

Neni 6 Procesi për Propozimin e Ndryshimeve në Kontrollet mbi Sistemet e Mbrojtjes Antivegjetative për Anijet

1. Çdo Palë mund të propozojë një ndryshim në shtojcën 1, në përputhje me këtë nen.
2. Një propozim fillestar përmban informacionin e kërkuar në shtojcën 2 dhe i dërgohet

Organizatës. Kur Organizata merr një propozim, ajo e sjell propozimin në vëmendje të Palëve, Anëtarëve të Organizatës, Kombeve të Bashkuara dhe Agjencive të specializuara të saj, organizatave ndërqeveritare, që kanë marrëveshje me Organizatën dhe organizatave joqeveritare në status konsultativ me Organizatën dhe e vendos atë në dispozicion të tyre.

3. Komiteti vendos nëse sistemi i mbrojtjes antivegetative për anijet në fjalë garanton një rishikim më të thelluar bazuar në propozimin fillestar. Nëse Komiteti vendos që rishikimi i mëtejshëm është i garantuar, ai i kërkon Palës propozuese t'i paraqesë Komitetit një propozim gjithëpërfshirës që të përmbajë informacionin e kërkuar në shtojcën 3, përveç rastit kur propozimi fillestar përfshin, gjithashtu, të gjitha informacionet e kërkuara në shtojcën 3. Nëse Komiteti është i mendimit se ekziston një kërcënim për dëmtime të rënda ose të pakthyeshme, mungesa e sigurisë së plotë shkencore nuk do të përdoret si arsye për të parandaluar një vendim për të vazhduar me vlerësimin e propozimit. Komiteti krijon një grup teknik në përputhje me nenin 7.

4. Grupi teknik rishikon propozimin gjithëpërfshirës së bashku me të dhënat shtesë të paraqitura nga çdo subjekt i interesuar dhe vlerëson dhe raporton para Komitetit nëse propozimi ka demonstruar një potencial për një rrezik të paarsyeshëm të efekteve të dëmshme në organizmat e pasynuar ose në shëndetin e njeriut, në mënyrë që të garantohet ndryshimi i shtojcës 1. Në këtë aspekt:

a) Shqyrtimi i grupit teknik përfshin:

i. një vlerësim të lidhjes midis sistemit të mbrojtjes antivegetative për anijet në fjalë dhe efekteve negative përkatëse të vëzhguara qoftë në mjedis ose në shëndetin e njeriut, duke përfshirë, por pa u kufizuar, në konsumin e ushqimit të prekur të detit ose përmes studimeve të kontrolluara bazuar në të dhënat e përshkruara në shtojcën 3 dhe çdo të dhënë tjetër të rëndësishme që del në dritë;

ii. një vlerësim të reduktimit të rrezikut të mundshëm që u atribuohet masave të propozuara të kontrollit dhe çdo mase tjetër kontrolli që mund të merret parasysh nga grupi teknik;

iii. shqyrtimi i informacionit në dispozicion për fizibilitetin teknik të masave të kontrollit dhe për kosto-efikasitetin e propozimit;

iv. marrja në konsideratë e informacionit në dispozicion për efektet e tjera nga përfshirja e këtyre masave të kontrollit, në lidhje me:

- mjedisin (përfshirë, por pa u kufizuar, në koston e mosveprimit dhe ndikimin në cilësinë e ajrit);

- shqetësimet për shëndetin dhe sigurinë në kantierin detar (d.m.th. ndikimi të punëtorët e kantierit detar);

- kostoja për transportin ndërkombëtar dhe sektorët e tjerë përkatës; dhe

v. marrja parasysh e disponueshmërisë së alternativave të përshtatshme, përfshirë marrjen parasysh të rreziqeve të mundshme të alternativave.

b) Raporti i grupit teknik do të jetë me shkrim dhe do të marrë parasysh secilin prej vlerësimeve dhe përllogaritjeve të përmendura në nënparagrafin (a), me përjashtim të rastit kur grupi teknik mund të vendosë që të mos vazhdojë me vlerësimet dhe përllogaritjet e përshkruara në nënparagrafin (a)(ii) përmes (a)(v) nëse përcakton pas vlerësimit në nënparagrafin (a)(i) që propozimi nuk kërkon shqyrtim të mëtejshëm.

c) Raporti i grupit teknik përfshin, *ndër të tjera*, një rekomandim nëse kontrollet ndërkombëtare, në përputhje me këtë Konventë, janë të garantuara në sistemin e mbrojtjes antivegetative për anijet, mbi përshtatshmërinë e masave specifike të kontrollit të sugjeruara në propozimin gjithëpërfshirës ose në masa të tjera kontrolli për të cilat beson se janë më të përshtatshme.

5. Raporti i grupit teknik do t'u shpërndahet Palëve, anëtarëve të Organizatës, Kombeve të Bashkuara dhe agjencive të specializuara të saj, organizatave ndërqeveritare që kanë marrëveshje me Organizatën dhe organizatave joqeveritare në status konsultativ me Organizatën, përpara shqyrtimit të tij nga Komiteti. Komiteti vendos nëse do të miratojë ndonjë propozim për të

ndryshuar shtojcën 1 dhe çdo ndryshim në të, nëse është e përshtatshme, duke marrë parasysh raportin e grupit teknik. Nëse raporti kërcënohet nga një dëmtim i rëndë ose i pakthyesëm, mungesa e sigurisë së plotë shkencore nuk do të përdoret si arsye për të parandaluar marrjen e një vendimi për të renditur një sistem mbrojtje antivegetative për anijet, në shtojcën 1. Ndryshimet e propozuara në shtojcën 1, nëse miratohen nga Komiteti, do të qarkullojnë në përputhje me nenin 16(2)(a). Një vendim për të mos miratuar propozimin nuk do të pengojë paraqitjen e ardhshme të një propozimi të ri, në lidhje me një sistem të veçantë mbrojtje antivegetative për anijet nëse zbulohet ndonjë informacion i ri.

6. Vetëm Palët mund të marrin pjesë në vendimet e marra nga Komiteti i përshkruar në paragrafët (3) dhe (5).

Neni 7

Grupet teknike

1. Komiteti krijon një grup teknik në përputhje me nenin 6 kur merret një propozim gjithëpërfshirës. Në rrethanat kur disa propozime janë marrë njëkohësisht ose njëra pas tjetrës, Komiteti mund të krijojë një ose më shumë grupe teknike sipas nevojës.

2. Çdo Palë mund të marrë pjesë në diskutimet e një grupi teknik dhe duhet të mbështetet në ekspertizën përkatëse të disponueshme për atë Palë.

3. Komiteti vendos për kushtet e referencës, organizimin dhe funksionimin e grupeve teknike. Këto kushte sigurojnë mbrojtjen e çdo informacioni konfidencial që mund të paraqitet. Grupet teknike mund të mbajnë takime të tilla siç kërkohet, por përpiqen të kryejnë punën e tyre përmes korrespondencës me shkrim ose elektronike, ose mjeteve të tjera, sipas rastit.

4. Vetëm përfaqësuesit e Palëve mund të marrin pjesë në formulimin e çdo rekomandimi për Komitetin, në përputhje me nenin 6. Një grup teknik përpiqet të arrijë unanimitetin midis përfaqësuesve të Palëve. Nëse unanimiteti nuk është i mundur, grupi teknik i komunikon çdo pikëpamje të pakicave të këtyre përfaqësuesve.

Neni 8

Kërkimi shkencor dhe teknik dhe monitorimi

1. Palët do të marrin masat e duhura për të nxitur dhe për të lehtësuar kërkimin shkencor dhe teknik mbi efektet e sistemeve të mbrojtjes antivegetative për anijet, si dhe monitorimin e këtyre efekteve. Në veçanti, ky kërkim duhet të përfshijë vëzhgimin, matjen, marrjen e mostrave, vlerësimin dhe analizën e efekteve të sistemeve të mbrojtjes antivegetative për anijet.

2. Çdo Palë, për të çuar më tej objektivat e kësaj Konvente, promovon disponueshmërinë e informacionit përkatës për Palët e tjera që e kërkojnë atë në:

- a) aktivitete shkencore dhe teknike të ndërmarra në përputhje me këtë Konventë;
- b) programe detare shkencore dhe teknologjike dhe objektivat e tyre; dhe
- c) efektet e vëzhguara nga çdo program monitorimi dhe vlerësimi, që ka të bëjë me sistemet e mbrojtjes antivegetative për anijet.

Neni 9

Komunikimi dhe shkëmbimi i informacionit

1. Secila Palë merr përsipër t'i komunikojë Organizatës:

- a) një listë të mbikëqyrësve të caktuar ose organizatave të njohura, që janë të autorizuar të veprojnë në emër të asaj Pale në administrimin e çështjeve, në lidhje me kontrollin e sistemeve të mbrojtjes antivegetative për anijet në përputhje me këtë Konventë për qarkullimin e informacionit të punonjësve të tyre të Palët. Ndaj, Administrata njofton Organizatën për përgjegjësitë dhe kushtet specifike të autoritetit të deleguar për mbikëqyrësit e caktuar ose organizatat e njohura; dhe

b) mbi baza vjetore, për informacionin në lidhje me çdo sistem të mbrojtjes antivegetative për anijet të miratuar, të kufizuar ose të ndaluar në bazë të ligjit të saj të brendshëm.

2. Organizata vendos në dispozicion, me çdo mjet të përshtatshëm, informacionin që i komunikohet asaj nën paragrafin 1.

3. Për ato sisteme të mbrojtjes antivegetative për anijet, të miratuara, të regjistruara ose të licencuara nga një Palë, pala në fjalë duhet të sigurojë ose kërkojë nga prodhuesit e këtyre sistemeve kundër ndotjes që të sigurojnë, për ato Palë që e kërkojnë atë, informacionin përkatës mbi të cilin u bazua vendimi i tij, përfshirë informacionin e parashikuar në shtojcën 3, ose informacione të tjera të përshtatshme për të bërë vlerësimin e duhur të sistemit kundër ndotjes. Nuk duhet të jepet asnjë informacion që mbrohet me ligj.

Neni 10

Vëzhgimi dhe certifikimi

Një Palë siguron që anijet të cilat gëzojnë të drejtën të ngrenë flamurin e saj ose të operojnë nën autoritetin e saj janë anketuar dhe certifikuar në përputhje me rregulloret në shtojcën 4.

Neni 11

Inspektimet e anijeve dhe zbulimi i shkeljeve

1. Anijet për të cilat zbatohet kjo Konventë, mund të inspektohen në çdo port, kantier detar, ose terminal në det të hapur të një Pale, nga nëpunësit e autorizuar të asaj Pale, me qëllim përcaktimin nëse anija është në përputhje me këtë Konventë. Nëse nuk ekzistojnë baza të qarta për të besuar se një anije është në shkelje të kësaj Konventë, çdo inspektim i tillë do të kufizohet në:

a) verifikimin se, kur lind nevoja, ekziston një Certifikatë e Vlefshme Ndërkombëtare e Sistemit të Mbrojtjes antivegetative për Anijet ose një Deklaratë për Sistemin të Mbrojtjes antivegetative për Anijet; dhe/ose

b) marrjen e mostrave të sistemit të mbrojtjes antivegetative për anijet, që nuk ndikon në integritetin, strukturën ose funksionimin e sistemit të mbrojtjes antivegetative për anijet, duke marrë parasysh udhëzimet e hartuara nga Organizata.¹ Megjithatë, koha e nevojshme për të përpunuar rezultatet e marrjes së këtyre mostrave nuk do të përdoret si bazë për të parandaluar lëvizjen dhe nisjen e anijes.

2. Nëse ka arsye të qarta për të besuar se anija është në shkelje të kësaj Konvente, mund të kryhet një inspektim i plotë, duke marrë parasysh udhëzimet e hartuara nga Organizata.*

3. Nëse zbulohet se anija është në kundërshtim me këtë Konventë, Pala që kryen inspektimin mund të ndërmerret hapa për të paralajmëruar, ndaluar, hequr ose përjashtuar anijen nga portet e saj. Pala që ndërmerr një veprim të tillë kundër një anijeje, për arsyen që anija nuk është në përputhje me këtë Konventë, duhet të informojë menjëherë Administratën e anijes në fjalë.

4. Palët do të bashkëpunojnë në zbulimin e shkeljeve dhe zbatimin e kësaj Konvente. Një Palë, gjithashtu, mund të inspektojë një anije kur hyn në porte, kantiere detare ose terminale në det nën juridiksionin e saj, nëse merret një kërkesë për hetim nga ndonjë Palë, së bashku me prova të mjaftueshme që anija është duke operuar ose ka operuar në kundërshtim me këtë Konventë. Raporti i këtij hetimi do t'i dërgohet Palës që ka drejtuar kërkesën dhe autoritetit kompetent të administrimit të anijes në fjalë, në mënyrë që të mund të merren masat e duhura në bazë të kësaj Konvente.

Neni 12

¹ * Duhet të hartohen udhëzime.

Shkeljet

Ndalohet çdo shkelje e kësaj Konvente dhe si rrjedhojë do të vendosen sanksione sipas ligjit të administrimit të anijes në fjalë kudo që të ndodhë shkelja. Nëse Administrata informohet për këto shkelje, ajo do të hetojë çështjen dhe mund t'i kërkojë Palës raportuese të sigurojë prova shtesë për shkeljen e pretenduar. Nëse Administrata është e bindur që disponohen prova të mjaftueshme për të mundësuar nisjen e procedurave, në lidhje me shkeljen e pretenduar, ajo do të bëjë që këto procedura të ndërmerren sa më shpejt të jetë e mundur, në përputhje me ligjet e saj. Administrata informon menjëherë Palën që ka raportuar shkeljen e pretenduar, si dhe Organizatën, për çdo veprim të ndërmarrë. Nëse Administrata nuk ka ndërmarrë ndonjë veprim brenda një viti pas marrjes së informacionit, ajo duhet të informojë Palën ka raportuar shkeljen e pretenduar.

Ndalohet çdo shkelje e kësaj Konvente brenda juridiksionit të ndonjë Pale dhe, si rrjedhojë, vendosen sanksione sipas ligjit të asaj Pale. Kurdo që të ndodhë kjo shkelje, Pala duhet:

- a) të nxisë ndërmarrjen e procedurave, në përputhje me ligjin e saj; ose
- b) t'i dorëzojë Administratës së anijes në fjalë ato informacione dhe prova që zotëron, të cilat tregojnë se ka ndodhur një shkelje.

Sanksionet e vendosura në bazë të ligjeve të një Pale, në përputhje me këtë nen, do të jenë mjaft të rrepta për të kundërshtuar shkeljet e kësaj Konvente, kudo që ato ndodhin.

Neni 13

Vonesat ose ndalimi i anijeve

1. Bëhen të gjitha përpjekjet e mundshme për të shmangur që një anije të ndalohet ose vonohet padrejtësisht, sipas neneve 11 ose 12.

2. Kur një anije ndalohet ose vonohet padrejtësisht, sipas neneve 11 ose 12, ajo ka të drejtë të kompensohet për çdo humbje ose dëm të pësuar.

Neni 14

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Palët zgjidhin çdo mosmarrëveshje ndërmjet tyre, në lidhje me interpretimin ose zbatimin e kësaj Konvente, përmes negociatave, hetimeve, ndërmjetësimit, pajtimit, arbitrazhit, zgjidhjes gjyqësore, përdorimit të agjencive ose marrëveshjeve rajonale ose mjeteve të tjera paqësore, sipas zgjedhjes së tyre.

Neni 15

Marrëdhënia me të Drejtën Ndërkombëtare të Detit

Asgjë në këtë Konventë nuk mund të cenohet të drejtat dhe detyrimet e çdo shteti nën të drejtën ndërkombëtare zakonore, siç pasqyrohet në Konventën e Kombeve të Bashkuara për Ligjin e Detit.

Neni 16

Ndryshimet

1. Kjo Konventë mund të ndryshohet nga secila prej procedurave të specifikuar në paragrafët e mëposhtëm.

2. Ndryshimet pas shqyrtimit brenda Organizatës:

a) Çdo Palë mund të propozojë një ndryshim në këtë Konventë. Ndryshimi i propozuar i paraqitet Sekretarit të Përgjithshëm, i cili më pas ua shpërndan atë Palëve dhe anëtarëve të

Organizatës, së paku gjashtë muaj para shqyrtimit të tij. Në rastin e një propozimi për të ndryshuar shtojcën 1, ai përpunohet në përputhje me nenin 6, para shqyrtimit të tij nën këtë artikull.

b) Një ndryshim i propozuar dhe i qarkulluar si më sipër i referohet Komitetit për shqyrtim. Palët, qofshin apo jo anëtarë të Organizatës, kanë të drejtë të marrin pjesë në procedurat e Komitetit për shqyrtim dhe miratim të ndryshimit.

c) Ndryshimet duhet të miratohen nga një shumicë prej dy të tretat e Palëve, që janë të pranishme dhe votojnë në Komitet, me kusht që të paktën një e treta e Palëve të jetë e pranishme në kohën e votimit.

d) Ndryshimet e miratuara në përputhje me nënparagrafin (c) u komunikohen Palëve nga Sekretari i Përgjithshëm për t'u pranuar.

e) Një ndryshim konsiderohet se është pranuar, në rrethanat në vijim:

i. Një ndryshim në një artikull të kësaj Konvente konsiderohet si i pranuar në datën në të cilën dy të tretat e Palëve njoftojnë Sekretarin e Përgjithshëm për pranimin e tij.

ii. Një ndryshim në një shtojcë konsiderohet si i pranuar në fund të dymbëdhjetë muajve pas datës së miratimit ose një date tjetër, siç përcaktohet nga Komiteti. Megjithatë, nëse deri në atë datë, më shumë se një e treta e Palëve njofton Sekretarin e Përgjithshëm se kundërshton ndryshimin, do të konsiderohet se nuk është pranuar.

f) Një ndryshim hyn në fuqi sipas kushteve në vijim:

i. Një ndryshim në një artikull të kësaj Konvente hyn në fuqi për ato Palë që kanë deklaruar se e kanë pranuar atë gjashtë muaj pas datës në të cilën konsiderohet se është pranuar, në përputhje me nënparagrafin (e)(i);

ii. Një ndryshim në shtojcën 1 hyn në fuqi, në lidhje me të gjitha Palët, gjashtë muaj pas datës në të cilën konsiderohet se është pranuar, me përjashtim të çdo Pale që ka:

1. njoftuar kundërshtimin e saj për ndryshimin, në përputhje me nënparagrafin (e)(ii) dhe që nuk e ka tërhequr këtë kundërshtim;

2. njoftuar Sekretarin e Përgjithshëm, para hyrjes në fuqi të këtij ndryshimi, se ndryshimi hyn në fuqi për të vetëm pas njoftimit pasues të pranimin të tij; ose

3. bërë një deklaratë në momentin kur ka dërguar instrumentin e saj të ratifikimit, pranimin ose miratimit të kësaj Konvente që ndryshimet në shtojcën 1 do të hyjnë në fuqi për të vetëm pasi të njoftohet Sekretari i Përgjithshëm për pranimin e këtyre ndryshimeve.

iii. Një ndryshim në një shtojcë tjetër përveç shtojcës 1 do të hyjë në fuqi, në lidhje me të gjitha Palët, gjashtë muaj pas datës në të cilën konsiderohet të jetë pranuar, përveç atyre Palëve që kanë njoftuar kundërshtimin e tyre për ndryshimin në përputhje me nënparagrafin (e)(ii) dhe që nuk e kanë tërhequr këtë kundërshtim.

g) i. Një Palë që ka njoftuar një kundërshtim nën nënparagrafin (f)(ii)(1) ose (iii) mund të njoftojë më pas Sekretarin e Përgjithshëm se pranon ndryshimin. Ky ndryshim hyn në fuqi për atë Palë gjashtë muaj pas datës së njoftimit të tij për pranimin ose datës në të cilën hyn në fuqi ndryshimi, cilado që është data e mëvonshme.

ii) Nëse një Palë që ka bërë një njoftim ose deklaratë të përmendur në nënparagrafin (f)(ii) (2) ose (3), përkatësisht, njofton Sekretarin e Përgjithshëm për pranimin lidhur me ndryshimin, ky ndryshim do të hyjë në fuqi për atë Palë gjashtë muaj pas datës së njoftimit të tij të pranimin, ose datës në të cilën ndryshimi hyn në fuqi, cilado qoftë data e mëvonshme.

3. Ndryshimi nga një Konferencë:

a) Me kërkesën e një Pale të miratuar nga të paktën një e treta e Palëve, Organizata do të thërrasë Palët në një Konferencë për të shqyrtuar ndryshimet në këtë Konventë.

b) Një ndryshim i miratuar nga kjo Konferencë nga një shumicë prej dy të tretat e Palëve të pranishme dhe që votojnë do t'u komunikohet nga Sekretari i Përgjithshëm të gjitha Palëve për miratim.

c) Përveç nëse Konferenca vendos ndryshe, ndryshimi do të konsiderohet se është miratuar dhe do të hyjë në fuqi, në përputhje me procedurat e përcaktuara në paragrafët (2)(e) dhe (f),

përkatësisht, të këtij neni.

4. Çdo Palë që ka refuzuar të miratojë një ndryshim në një shtojcë do të trajtohet si jopalë vetëm për qëllimin e zbatimit të këtij ndryshimi.

5. Do të propozohet dhe miratohet një shtesë e një shtojce të re dhe do të hyjë në fuqi, në përputhje me procedurën e zbatueshme për një ndryshim në një nenin e kësaj Konvente.

6. Çdo njoftim ose deklaratë sipas këtij neni i bëhet me shkrim Sekretarit të Përgjithshëm.

7. Sekretari i Përgjithshëm informon Palët dhe Anëtarët e Organizatës, për:

a) çdo ndryshim që hyn në fuqi dhe datën e hyrjes së tij në fuqi në përgjithësi dhe për secilën Palë; dhe

b) çdo njoftim ose deklaratë të bërë sipas këtij neni.

Neni 17

Nënshkrimi, ratifikimi, pranimi, miratimi dhe aderimi

1. Kjo Konventë është e hapur për nënshkrim nga çdo shtet në selinë e organizatës nga 1 shkurti 2002 deri më 31 dhjetor 2002 dhe pas kësaj do të mbetet e hapur për t'u aderuar nga çdo shtet.

2. Shtetet mund të bëhen palë të kësaj Konvente nga:

a) nënshkrimi, që nuk i nënshtrohet ratifikimit, pranimit ose miratimit; ose

b) nënshkrimi që i nënshtrohet ratifikimit, pranimit ose miratimit, i ndjekur nga ratifikimi, pranimi ose miratimi; ose

c) aderimi.

3. Ratifikimi, pranimi, miratimi ose aderimi do të kryhet me depozitimin e një instrumenti për atë qëllim, pranë Sekretarit të Përgjithshëm.

4. Nëse një shtet përfshin dy ose më shumë njësi territoriale, në të cilat zbatohen sisteme të ndryshme të ligjit, në lidhje me çështjet e trajtuara në këtë Konventë, ai mund të deklarojë në kohën e nënshkrimit, ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit, se kjo Konventë do të shtrihet në të gjitha njësitë e saj territoriale ose vetëm në një ose më shumë prej tyre dhe mund të modifikojnë këtë deklaratë duke paraqitur një deklaratë tjetër në çdo kohë.

5. Këto deklarata i komunikohen Sekretarit të Përgjithshëm dhe shprehin qartësisht njësitë territoriale për të cilat zbatohet kjo Konventë.

Neni 18

Hyrja në fuqi

1. Kjo Konventë hyn në fuqi dymbëdhjetë muaj pas datës në të cilën jo më pak se njëzet e pesë shtete, flotat tregtare të kombinuara të të cilave përbëjnë jo më pak se njëzet e pesë për qind të tonazhit bruto të anijeve tregtare të botës kanë nënshkruar atë pa rezerva për ratifikimin, pranimin ose miratimin, ose kanë depozituar instrumentin e nevojshëm të ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit në përputhje me nenin 17.

2. Për shtetet që kanë depozituar një instrument të ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit, në lidhje me këtë Konventë, pasi të jenë përmbushur kërkesat për hyrjen e tij në fuqi, por përpara datës së hyrjes në fuqi, ratifikimi, pranimi, miratimi ose aderimi do të hyjë në fuqi në datën e hyrjes në fuqi të kësaj Konvente ose tre muaj pas datës së depozitimit të instrumentit, cilado qoftë data e mëvonshme.

3. Çdo instrument i ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit i depozituar pas datës në të cilën hyn në fuqi kjo Konventë do të hyjë në fuqi tre muaj pas datës së depozitimit.

4. Pas datës në të cilën konsiderohet të jetë pranuar një ndryshim në këtë Konventë në bazë të nenit 16, çdo instrument i ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit i depozituar zbatohet në Konventën e ndryshuar.

Neni 19
Denoncimi

1. Kjo Konventë mund të denoncohet nga çdo Palë në çdo kohë pas përfundimit të dy viteve nga data në të cilën kjo Konventë hyn në fuqi për atë Palë.

2. Denoncimi kryhet përmes dërgimit të njoftimit me shkrim pranë Sekretarit të Përgjithshëm, që do të hyjë në fuqi një vit pas marrjes ose në një periudhë më të gjatë siç mund të specifikohet në atë njoftim.

Neni 20
Depozituesi

1. Kjo Konventë depozitohet te Sekretari i Përgjithshëm, i cili ua transmeton kopjet e noterizuara të kësaj Konvente të gjitha shteteve, që kanë nënshkruar këtë Konventë ose janë aderuar në të.

2. Përveç funksioneve të përcaktuara diku tjetër në këtë Konventë, Sekretari i Përgjithshëm:

a) informon të gjitha shtetet që kanë nënshkruar këtë Konventë ose janë aderuar në të, për:

i. çdo nënshkrim ose depozitë e re të një instrumenti të ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit, së bashku me datën e tij;

ii. datën e hyrjes në fuqi të kësaj Konvente; dhe

iii. depozitim të çdo instrumenti të denoncimit të kësaj Konvente, së bashku me datën në të cilën është marrë dhe datën në të cilën denoncimi hyn në fuqi; dhe

b) sapo të hyjë në fuqi kjo Konventë, i transmeton tekstin e saj Sekretariatit të Kombeve të Bashkuara për regjistrim dhe publikim, në përputhje me nenin 102, të Kartës së Kombeve të Bashkuara.

Neni 21
Gjuhët

Kjo Konventë është hartuar në një dokument të vetëm origjinal në gjuhët arabe, kineze, angleze, frënge, ruse dhe spanjolle, me tekst të njëjtë origjinal.

Në dëshmi të sa më sipër, nënshkruesit duke qenë të autorizuar siç duhet nga qeveritë e tyre përkatëse për atë qëllim, kanë nënshkruar këtë Konventë.

E nënshkruar në Londër, sot më pesë tetor dy mijë e një.

KONTROLLET NË SISTEMET E MBROJTJES ANTIVEGJETATIVE PËR ANIJET

Sistem i mbrojtjes antivegjetative për anijet	Masat e kontrollit	Zbatimi	Data e hyrjes në fuqi
Komponimet organike, të cilat veprojnë si biocide në sistemet e mbrojtjes antivegjetative për anijet	Anijet nuk duhet të apikojnë ose riaplikojnë këto komponime	Të gjitha anijet	1 janar 2003
Komponimet organotnike, të cilat veprojnë si biocide në sistemet e mbrojtjes antivegjetative për anijet	Anijet: 1. Nuk duhet të bartin këto komponime në trupin e tyre ose pjesët e jashtme ose sipërfaqet; ose 2. Duhet të bartin një shtresë që formon një barrierë për këto komponime, që lëshohen nga sisteme themelore të mbrojtjes antivegjetative për anijet në mospërputhje.	Të gjitha anijet (përveç platformave fikse dhe lundruese, FSU-ve dhe FPSO-ve, që janë ndërtuar para 1 janarit 2003 dhe që nuk kanë qenë në gjendje doku të thatë në ose pas 1 janarit 2003)	1 janar 2008

SHTOJCA 2 ELEMENTET E NEVOJSHME PËR NJË PROPOZIM FILLESTAR

1. Një propozim fillestar përfshin dokumentacionin e përshtatshëm që përmban të paktën sa vijon:

a) identifikimin e sistemit të mbrojtjes antivegjetative për anijet të adresuar në propozim: emrin e sistemit të mbrojtjes antivegjetative për anijet; emrin e përbërësve aktivë dhe numrin e Regjistrimit të Shërbimeve të Abstrakteve Kimike (numri CAS), sipas rastit; ose përbërësit e sistemit për të cilët dyshohet se shkaktojnë efekte negative shqetësuese;

b) karakterizimin e informacionit, i cili sugjeron që sistemi i mbrojtjes antivegjetative për anijet ose produktet e tij të transformimit mund të përbëjnë një rrezik për shëndetin e njeriut ose mund të shkaktojnë efekte të dëmshme në organizmat, të cilët nuk synohen në përqendrimet që mund të gjenden në mjedis (p.sh., rezultatet e studimeve të toksicitetit në speciet përfaqësuese ose të dhënat bioakumuluese);

c) materiale që mbështesin potencialin e komponentëve toksikë në sistemin e mbrojtjes antivegjetative për anijet, ose produktet e tij të transformimit, që të ndodhin në mjedis në përqendrimet që mund të rezultojnë në efekte të dëmshme për organizmat e patargetuar, shëndetin e njeriut, ose cilësinë e ujit (p.sh., të dhëna mbi qëndrueshmërinë e kolonës së ujit, sedimentet dhe bimësinë dhe jetesën e gjallesave ujore; shkalla e lëshimit të përbërësve toksikë nga sipërfaqet e trajtuara në studime ose në kushte aktuale të përdorimit; ose të dhënat e monitorimit, nëse janë të disponueshme);

d) një analizë të lidhjes midis sistemit të mbrojtjes antivegjetative për anijet, efekteve negative

përkatëse dhe përqendrimeve në mjedis të vëzhguara ose parashikuara; dhe

e) një rekomandim paraprak për llojin e kufizimeve që mund të jenë efektive në reduktimin e rreziqeve që lidhen me sistemin e mbrojtjes antivegetative për anijet.

2. Propozimi fillestar dorëzohet në përputhje me rregullat dhe procedurat e Organizatës.

SHTOJCA 3

ELEMENTET E NEVOJSHME TË NJË PROPOZIMI GJITHËPËRFSHIRËS

1. Një propozim gjithëpërfshirës përfshin dokumentacionin e përshtatshëm, që përmban sa vijon:

a) zhvillimet në të dhënat e cituara në propozimin fillestar;

b) gjetjet nga kategoritë e të dhënave të përcaktuara në paragrafët (3)(a), (b) dhe (c), sipas rastit, në varësi të temës së propozimit dhe identifikimit ose përshkrimit të metodologjive nën të cilat janë zhvilluar të dhënat;

c) një përmbledhje të rezultateve të studimeve të kryera mbi efektet negative të sistemit të mbrojtjes antivegetative për anijet;

d) nëse është kryer ndonjë monitorim, një përmbledhje të rezultateve të këtij monitorimi, përfshirë informacionin mbi trafikun e anijeve dhe një përshkrim të përgjithshëm të zonës së monitoruar;

e) një përmbledhje të të dhënave në dispozicion për ekspozimin mjedisor ose ekologjik dhe çdo vlerësim të përqendrimeve në mjedis të zhvilluara përmes aplikimit të modeleve matematikore, duke përdorur të gjithë parametrat e mundshëm të fatit mjedisor, mundësisht ata që janë përcaktuar në mënyrë eksperimentale, së bashku me identifikimin ose përshkrimin e metodologjisë së modelimit;

f) një vlerësim të lidhjes midis sistemit të mbrojtjes antivegetative për anijet, efekteve negative përkatëse dhe përqendrimeve në mjedis të vëzhguara ose parashikuara;

g) një deklaratë cilësore të nivelit të pasigurisë në vlerësimin e përmendur në nënparagrafin (f);

h) një rekomandim të masave specifike të kontrollit për të reduktuar rreziqet që lidhen me sistemin e mbrojtjes antivegetative për anijet;

i) një përmbledhje të rezultateve të çdo studimi në dispozicion mbi efektet e mundshme të masave të rekomanduara të kontrollit, në lidhje me cilësinë e ajrit, kushteve të anijeve, transportit ndërkombëtar dhe sektorëve të tjerë përkatës, si dhe disponueshmërinë e alternativave të përshtatshme.

2. Një propozim gjithëpërfshirës përfshin, gjithashtu, informacione për secilën nga karakteristikat fizike dhe kimike në vijim të përbërësve shqetësues, nëse aplikohet:

- pika e shkrirjes;
- pika e vlimit;
- densiteti (densiteti relativ);
- presioni i avullit;
- tretshmëria në ujë/pH/ konstanta e ndarjes (pKa);
- oksidimi/reduktimi i potencialit;
- masa molekulare;
- struktura molekulare; dhe
- veti të tjera fizike dhe kimike të identifikuara në propozimin fillestar.

3. Për qëllime të paragrafit (1)(b) më sipër, kategoritë e të dhënave janë:

a) Të dhëna mbi fatin dhe ndikimin mjedisor:

- mënyrat e degradimit/shpërndarjes (p.sh., hidroliza/fotodegradimi/biodegradimi);
- qëndrueshmëria në mjetin përkatës së komunikimit (p.sh. kolona e ujit/sedimentet/biota);
- sedimentet/ndarja e ujit;
- shkalla e lëshimit të biocidëve ose përbërësve aktivë;
- bilanci i masës;

- bioakumulimi, koeficienti i ndarjes, koeficienti i oktanolit/ujit; dhe
- çdo reaksion i ri mbi lëshimin ose efektet e njohura ndërvepruese.

b) Të dhëna për çdo efekt të padëshiruar në bimët ujore, jovertebrorët, peshqit, shpendët e detit, gjitarët detarë, speciet e rrezikuara, biotat e tjera, cilësinë e ujit, ose habitatin e organizmave të pasynuar, përfshirë organizmat e ndjeshëm dhe përfaqësues:

- toksiciteti akut;
- toksiciteti kronik;
- toksiciteti zhvillimor dhe riprodhues;
- çrregullimi i endokrinës;
- toksiciteti i sedimentit;
- biodisponibiliteti/biomagnifikimi/biokoncentrimi;
- zinxhiri ushqimor/efektet e popullsisë;
- vëzhgime të efekteve negative në fushë/vrasjet e peshqve/bllokimi/analizat e indeve; dhe
- mbetjet në ushqimet e detit.

Këto të dhëna do të lidhen me një ose më shumë lloje të organizmave të pasynuar si bimët ujore, jovertebrorët, peshqit, zogjtë, gjitarët dhe speciet e rrezikuara.

c) Të dhëna mbi mundësinë e ndikimeve në shëndetin e njeriut (duke përfshirë, por jo kufizuar në, konsumin e ushqimit të prekur të detit).

4. Propozimi gjithëpërfshirës përfshin një përshkrim të metodologjive të përdorura, si dhe të gjitha masave përkatëse të marra për sigurimin e cilësisë dhe çdo rishikim të studimeve të kryer nga kolegët.

SHTOJCA 4

KËRKESAT E VËZHGIMIT DHE TË CERTIFIKIMIT PËR RREGULLIMIN E SISTEMEVE TË MBROJTJES ANTIVEGJETATIVE PËR ANIJET

RREGULLORJA 1 STUDIMET

1. Anijet me tonazh bruto 400 dhe të përmendura më sipër në nenin 3(1)(a) të angazhuara në udhëtime ndërkombëtare, duke përfshirë platformat fikse ose lundruese, FSU-të dhe FPSO-të, do t'i nënshtrohen studimit të specifikuar në vijim:

a) një studim fillestar përpara se anija të vihet në punë ose përpara se të lëshohet për herë të parë Certifikata Ndërkombëtare e Sistemit të mbrojtjes antivegjetative për anijet (Certifikata) e kërkuar sipas rregulloreve 2 ose 3; dhe

b) një studim ku sistemet e mbrojtjes antivegjetative për anijet ndryshohen ose zëvendësohen. Këto studime miratohen në Certifikatën e lëshuar në bazë të rregulloreve 2 ose 3.

2. Këto studime do të jenë të tilla që të sigurojnë që sistemi i mbrojtjes antivegjetative për anijen të jetë tërësisht në përputhje me këtë Konventë.

3. Administrata vendos masa të përshtatshme për anijet që nuk u nënshtrohen dispozitave të paragrafit (1) të kësaj rregulloreje, në mënyrë që të sigurohen se është respektuar kjo Konventë.

4. a) Sa i përket zbatimit të kësaj Konvente, vëzhgimet mbi anijet kryhen nga zyrtarë të autorizuar, siç duhet nga Administrata ose siç parashikohet në rregulloren 3(1), duke marrë parasysh udhëzimet për vëzhgimet e zhvilluara nga Organizata². Përndryshe, Administrata mund t'ua besojë vëzhgimet e kërkuara nga kjo Konventë mbikëqyrësve të caktuar për atë qëllim ose organizatave të njohura prej saj.

b) Një administratë që cakton mbikëqyrës ose miraton organizata³ për kryerjen e vëzhgimit, autorizon minimalisht çdo autorizues të caktuar ose një organizatë të miratuar, për:

² Duhet të hartohen udhëzime.

³ Referojuni udhëzimeve të miratuara nga Organizata me rezolutën A.739(18), të ndryshuar nga Organizata, dhe specifikimeve të miratuara nga Organizata me rezolutën A.789(19), të ndryshuar nga Organizata.

i. t'i kërkuar anijes që ajo vëzhgon që të respektojë dispozitat e shtojcës 1; dhe
ii. të kryejnë vëzhgime nëse kërkohet nga autoritetet përkatëse të një shteti portual që është palë e kësaj Konvente.

c) Kur Administrata, një vëzhgues i caktuar ose një organizatë e njohur përcakton që sistemi i mbrojtjes antivegetative i anijes nuk përputhet me të dhënat e një Certificate të kërkuar, sipas rregullores 2 ose 3, ose me kërkesat e kësaj Konvente, Administrata, Vëzhguesi ose organizata siguron menjëherë që të merren veprime korrigjuese që anija të jetë në përputhje. Vëzhguesi ose organizata, gjithashtu, njofton në kohën e duhur Administratën për çdo përcaktim të tillë. Nëse nuk ndërmerret veprimi i duhur korrigjues, njoftohet menjëherë Administrata dhe ajo siguron që Certificate të mos lëshohet ose tërhiqet sipas rastit.

d) Në situatën e përshkruar në nënparagrafin (c), nëse anija është në portin e një Pale tjetër, njoftohen menjëherë autoritetet përkatëse të shtetit portual. Kur Administrata, një mbikëqyrës i caktuar ose një organizatë e njohur njofton autoritetet e duhura të Shtetit Portual, Qeveria e Shtetit Portual në fjalë do t'u japë Administratës, mbikëqyrësit ose organizatës, çdo ndihmë të nevojshme për të kryer detyrimet e tyre sipas kësaj rregulloreje, përfshirë çdo veprim të përshkruar në nenet 11 ose 12.

RREGULLORE 2

LËSHIMI OSE MIRATIMI I NJË CERTIFIKATE NDËRKOMBËTARE TË SISTEMIT TË MBROJTJES ANTIVEGETATIVE PËR ANIJET

1. Administrata kërkon që një anije, për të cilën zbatohet rregullorja 1, të pajiset me një Certificate pas përfundimit të suksesshëm të një vëzhgimi, në përputhje me rregulloren 1. Certificate e lëshuar nën autoritetin e një Pale do të pranohet nga Palët e tjera dhe do të konsiderohet për të gjitha qëllimet e përfshira në këtë Konventë se ka të njëjtën vlefshmëri si një Certificate e lëshuar prej tyre.

2. Certificate të lëshohen ose miratohen nga Administrata ose nga ndonjë person ose organizatë e autorizuar siç duhet nga ajo. Në çdo rast, Administrata merr përgjegjësinë e plotë për Certificate.

3. Për anijet që kanë një sistem mbrojtjes antivegetative për anijet të kontrolluar nën shtojcën 1, që është aplikuar përpara datës së hyrjes në fuqi të një kontrolli për këtë sistem, Administrata lëshon një Certificate, në përputhje me paragrafët 2 dhe 3 të kësaj rregulloreje, jo më vonë se dy vjet pas hyrjes në fuqi të këtij kontrolli. Ky paragraf nuk do të ndikojë në asnjë kërkesë që anijet të jenë në përputhje me shtojcën 1.

4. Certificate hartohet në formën që i përket modelit të dhënë në aneksin 1 të kësaj shtojce dhe shkruhet së paku në anglisht, frëngjisht, ose spanjisht. Nëse përdoret, gjithashtu, një gjuhë zyrtare e shtetit lëshues, kjo do të jetë gjuha që do të mbizotërojë në rast mosmarrëveshjeje ose mospërputhjeje.

RREGULLORE 3

LËSHIMI OSE MIRATIMI I NJË CERTIFIKATE NDËRKOMBËTARE TË SISTEMIT TË MBROJTJES ANTIVEGETATIVE PËR ANIJET NGA NJË PALË TJETËR

1. Me kërkesën e Administratës, një tjetër Palë mund të bëjë që anija të vëzhgohet dhe, nëse është e bindur që kjo Konventë është respektuar, ajo lëshon ose autorizon lëshimin e një Certificate për anijen dhe, sipas rastit, miraton ose autorizon miratimin e asaj Certificate për anijen, në përputhje me këtë Konventë.

2. Një kopje e Certificate dhe një kopje e raportit të studimit i transmetohen sa më shpejt të jetë e mundur Administratës që ka drejtuar kërkesën.

3. Një Certificate e lëshuar në këtë mënyrë përmban një deklaratë që është lëshuar me kërkesë të Administratës të përmendur në paragrafin 1 dhe ka të njëjtën fuqi dhe merr të njëjtën njohje si

një Certifikatë e lëshuar nga Administrata.

4. Nuk i lëshohet asnjë certifikatë një anijeje që ka të drejtë të ngrejë flamurin e një Shteti që nuk është Palë.

RREGULLORE 4

VLEFSHMËRIA E NJË CERTIFIKATE NDËRKOMBËTARE TË SISTEMIT TË MBROJTJES ANTIVEGJETATIVE PËR ANIJET

1. Një Certifikatë e lëshuar në bazë të rregulloreve 2 ose 3 nuk është më e vlefshme në secilin prej rasteve në vijim:

a) nëse sistemi të mbrojtjes antivegjetative për anijet është ndryshuar ose zëvendësuar dhe Certifikata nuk miratohet në përputhje me këtë Konventë; dhe

b) pas transferimit të anijes në flamurin e një Shteti tjetër. Një Certifikatë e re lëshohet vetëm kur Pala që lëshon Certifikatën e re është plotësisht e bindur që anija është në përputhje me këtë Konventë. Në rastin e një transferimi midis Palëve, nëse kërkohet brenda tre muajve pas kryerjes së transferimit, Pala, flamurin e së cilës anija ka pasur të drejtë të ngrejë më parë duhet, sa më shpejt të jetë e mundur, t'i dërgojë Administratës një kopje të Certifikatave të bartura nga anija përpara transferimit dhe, nëse është e mundur, një kopje e raporteve përkatëse të studimit.

2. Lëshimi i një Certifikate të re nga një Palë për një anije të transferuar nga një Palë tjetër mund të bazohet në një studim të ri ose në një Certifikatë të vlefshme të lëshuar nga Pala e mëparshme, flamurin e së cilës anija ka të drejtë të ngrejë.

RREGULLORE 5

DEKLARATË PËR SISTEMIN E MBROJTJES ANTIVEGJETATIVE PËR ANIJET

1. Administrata kërkon që një anije me gjatësi 24 metra ose më shumë, por më pak se 400 tonë bruto e angazhuar në udhëtime ndërkombëtare dhe për të cilën zbatohet neni 3(1)(a) (duke përfshirë platformat fikse ose lundruese, FSU-të dhe FPSO-të) të ketë një Deklaratë të nënshkruar nga pronari ose agjenti i autorizuar i pronarit. Kjo deklaratë shoqërohet me dokumentacionin e duhur (si, për shembull, fatura e bojës ose e kontraktorit) ose përmban miratimin e përshtatshëm.

2. Deklaratat hartohen në formën që i përket modelit të dhënë në aneksin 2 të kësaj shtojce dhe shkruhen së paku në anglisht, frëngjisht, ose spanjisht. Nëse përdoret, gjithashtu, një gjuhë zyrtare e një shteti, flamurin e të cilit anija ka të drejtë ta ngrejë, kjo do të jetë gjuha që do të mbizotërojë në rast mosmarrëveshjeje ose mospërputhjeje.

ANEKSI 1 I SHTOJCËS 4

FORMATI I MODELIT TË CERTIFIKATËS NDËRKOMBËTARE TË SISTEMIT TË MBROJTJES ANTIVEGJETATIVE PËR ANIJET

CERTIFIKATA NDËRKOMBËTARE E SISTEMIT TË MBROJTJES ANTIVEGJETATIVE PËR ANIJET

(Kjo Certifikatë plotësohet me anë të një Regjistrimi të Sistemeve të Mbrojtjes antivegjetative për anijet)

(Vula zyrtare)

(Shteti)

Lëshuar sipas

Konventës Ndërkombëtare për Kontrollin e Dëmit nga Sistemet e Mbrojtjes

Antivegjetative në Anije

nën autoritetin e Qeverisë së

.....
(emri i shtetit)
nga

.....
(personi ose organizata e
autorizuar)

Kur një certifikatë është lëshuar më parë, kjo Certifikatë zëvendëson certifikatën e datës

Të dhënat e anijes⁴

Emri i anijes
Numri ose shkronjat dalluese
Porti i regjistrimit
Tonazhi bruto
Numri i IMO-s⁵

Një sistem i mbrojtjes antivegjetative për anijet i kontrolluar nën shtojcën 1, që nuk është aplikuar gjatë ose pas ndërtimit të kësaj anije.

Një sistemi i mbrojtjes antivegjetative për anijet i kontrolluar nën shtojcën 1, i aplikuar më parë në këtë anije, por i hequr nga (shënimi emrin e objektit) më... (data).....¹

Një sistem i mbrojtjes antivegjetative për anijet i kontrolluar nën shtojcën 1 që është aplikuar më parë në këtë anije, por ka qenë i mbuluar nga një veshje ngjitëse e aplikuar nga (shënimi emrin e objektit)

..... më (data).....¹

Një sistemi i mbrojtjes antivegjetative për anijet i kontrolluar nën shtojcën 1 është aplikuar në këtë anije para... (data)⁶, por duhet të hiqet ose të mbulohet me një veshje ngjitëse para (data)⁷¹

KY DOKUMENT CERTIFIKON SE:

1. Anija është vëzhguar në përputhje me rregulloren 1 të Shtojcës 4 të Konventës; dhe
2. Studimi tregon se sistemi i mbrojtjes antivegjetative për anijet përputhet me kërkesat e zbatueshme të shtojcës 1 të Konventës.

Lëshuar në.....

(Vendi i lëshimit të Certifikatës)

.....
(Data e lëshimit)

.....
(Nënshkrimi i zyrtarit të autorizuar që lëshon Certifikatën)

Data e përfundimit të vëzhgimit
mbi të cilin lëshohet kjo Certifikatë:

⁴ Në të kundërt, të dhënat e anijes mund të vendosen horizontalisht në kuti.

⁵ Në përputhje me skemën e numrave të identifikimit të anijeve të IMO-s të miratuar nga Organizata me rezolutën e Asamblesë A.600(15).

⁶ Data e hyrjes në fuqi e masës së kontrollit.

⁷ Data e skadimit të çdo periudhe zbatimi të specifikuar në nenin 4(2) ose shtojcën 1.

FORMULARI I MODELIT TË REGJISTRIMIT TË SISTEMEVE TË MBROJTJES
ANTIVEGJETATIVE PËR ANIJET

REGJISTRI I SISTEMEVE TË MBROJTJES ANTIVEGJETATIVE PËR ANIJET
Ky Regjistër i bashkëngjitet në mënyrë të përhershme Certifikatës Ndërkombëtare të Sistemit
të Mbrojtjes Antivegjetative për Anijet

Të dhënat e anijeve

Emri i anijes :
Numri ose shkronjat dalluese :
Numri i IMO-s :

Detajet të zbatueshme të sistemeve të mbrojtjes antivegjetative për anijet

Llojet e sistemeve të mbrojtjes antivegjetative për anijet të
përdorura.....
.....

Datat e aplikimit të sistemeve të mbrojtjes antivegjetative për
anijet

Emrat e shoqërive dhe objekteve/vendeve ku aplikohet

Emrat e prodhuesve të sistemit të mbrojtjes antivegjetative për
anijet

Emrat dhe ngjyrat e sistemeve të mbrojtjes antivegjetative për
anijet

Përbërësit aktivë dhe Numri i Regjistrimit të Shërbimeve të Abstrakteve Kimike (numrat CAS)
.....

Llojet e veshjeve ngjitëse, nëse ka
.....
.....

Emrat dhe ngjyrat e veshjeve ngjitëse të aplikuara, nëse ka
.....
Data e aplikimit të veshjes ngjitëse

KJO VËRTETON SE ky regjistër është i saktë në të gjitha aspektet.

Lëshuar në.....
(Vendi i lëshimit të Regjistrimit)

.....
(Data e lëshimit)

.....
(Nënshkrimi i zyrtarit të autorizuar që lëshon regjistrin)

Miratimi i regjistrave⁸

KJO VËRTETON SE në studimin e kërkuar, në përputhje me rregulloren 1(1)(b) të shtojcës 4 të Konventës u konstatua se anija ishte në përputhje me Konventën.

Detajet të zbatueshme të sistemeve të mbrojtjes antivegetative për anijet

Llojet e sistemeve të mbrojtjes antivegetative për anijet të përdorura

.....

Datat e aplikimit të sistemeve të mbrojtjes antivegetative për

anijet

....

Emrat e shoqërive dhe vendndodhjeve të objekteve ku aplikohet.....

.....

Emrat e prodhuesve të sistemeve të mbrojtjes antivegetative për anijet

.....

Emrat dhe ngjyrat e sistemeve të mbrojtjes antivegetative për anijet

.....

Përbërësit aktivë dhe Numri i Regjistrit të Shërbimeve të Abstrakteve Kimike (numrat CAS) ...

.....

..... Llojet e veshjeve ngjitëse, nëse

ka

Emrat dhe ngjyrat e veshjeve ngjitëse të aplikuara, nëse ka

.....

.....Data e aplikimit të veshjes

ngjitëse

...

Nënshkroi:

(Nënshkrimi i zyrtarit të autorizuar që lëshon regjistrin)

Vendi:

Data⁹:

(Vula ose pulla e autoritetit)

ANEKSI 2 I SHTOJCËS 4

FORMULARI I MODELIT TË DEKLARIMIT TË SISTEMEVE TË MBROJTJES ANTIVEGJETATIVE PËR ANIJET

DEKLARATAT NË LIDHJE ME SISTEMET E MBROJTJES

⁸ Kjo faqe e Regjistrit do të riprodhohet dhe shtohet në Regjister kur të konsiderohet e nevojshme nga Administrata.

⁹ Data e përfundimit të studimit mbi të cilin është lëshuar ky miratim.

ANTIVEGJETATIVE PËR ANIJET

Hartuar sipas

Konventës Ndërkombëtare për Kontrollin e Dëmit nga Sistemet e Mbrojtjes antivegjetative në Anije

Emri i anijes

Numri ose shkronjat dalluese.....

Porti i regjistrimit

Gjatësia

Tonazhi bruto

Numri IMO (nëse ka)

Deklaroj që sistemi i mbrojtjes antivegjetative për anijet i përdorur në këtë anije përputhet me shtojcën 1 të Konventës

.....
(Data)

.....
(Nënshkrimi i pronarit ose agjentit të autorizuar të pronarit)

Miratimi i sistemeve të aplikuara të mbrojtjes antivegjetative për anijet

Llojet e sistemeve të përdorura të mbrojtjes antivegjetative për anijet dhe datat e aplikimit.....

.....

.....
(Data)

.....
(Nënshkrimi i pronarit ose i agjentit të autorizuar të pronarit)

Llojet e sistemeve të përdorura kundër ndotjes dhe datat e aplikimit.....

.....

.....
(Data)

.....
(Nënshkrimi i pronarit ose i agjentit të autorizuar të pronarit)

Llojet e sistemeve të përdorura kundër ndotjes dhe datat e aplikimit.....

.....

.....
(Data)

.....
(Nënshkrimi i pronarit ose i agjentit të autorizuar të pronarit)